VENDIM
Nr. 53, datë 29.1.2020

PËR MIRATIMIN E KUADRIT MAKROEKONOMIK E FISKAL, PËR PERIUDHËN 2021–2023

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal, për periudhën 2021–2023, sipas lidhjes nr. 1, "Treguesit kryesorë makroekonomikë", dhe lidhjeve nr. 2/1 e nr. 2/2, "Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar", që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL 2021–2023
Janar, 2020

Tabela e përmbajtjes

Shkurtime
Hyrje
1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike
2. Politikat fiskale
3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë
Metodologjia e parashikimeve makroekonomike
Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm
Lidhja nr. 1, "Treguesit kryesorë makroekonomikë"
Lidhja nr. 2/1, "Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milion lekë)"
Lidhja nr. 2/2, "Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)"

SHKURTIME

BB	Banka Botërore
BSH	Banka e Shqipërisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
KM	Këshilli i Ministrave
KMF	Kuadri makroekonomik dhe fiskal
LOB	Ligji organik i buxhetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
PBA	Programi buxhetor afatmesëm
PBB	Produkti i brendshëm bruto
SPI	Sistemi i planifikimit të integruar

VKM Vendim i Këshillit të Ministrave
WEO *World Economic Outlook*

KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL, 2021–2023
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Hyrje

Kuadri Makroekonomik e Fiskal (KMF), për periudhën 2021–2023, është pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe përgatitet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. KMF-ja ka për qëllim përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë. Ai projekton pritshmërinë makroekonomike në horizontin kohor afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e zërave të agreguar të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit. Ai përcakton synimet dhe objektivat e qeverisë, në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale, si: balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, balancën fiskale primare dhe atë korrente. KMF-ja shërben si bazë për përcaktimin e tavaneve në fazën e parë të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), 2021–2023, në nivel ministrie.

KMF-ja miratohet nga Këshilli i Ministrave në muajin janar të çdo viti, dhe mund të jetë sërish subjekt rishikimi dhe përditësimi përgjatë vitit, përpara finalizimit të PBA-së dhe të tavaneve për shpenzimet.

KMF-ja përmban dy komponentë kryesore: i. parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë, të cilët paraqesin pritshmërinë ekonomike për vitin aktual dhe tre vjetëve të ardhshëm; dhe ii. parashikimet dhe objektivat për treguesit fiskalë, të cilët paraqesin burimet e pritshme në dispozicion të qeverisë, për vitet 2021–2023, dhe shpërndarjen e tyre për këtë periudhë, sipas buxhetit të konsoliduar. Këto komponentë paraqiten në mënyrë tabelore në fund të këtij dokumenti, përkatësisht lidhja nr. 1; lidhja nr. 2/1; dhe lidhja nr. 2/2.

1. Zhvillimet më të fundit makroekonomike

Ritmi i rritjes ekonomike, përgjatë periudhës kumulative nëntëmujore të vitit 2019, është ngadalësuar krahasuar me rritjen e vazhdueshme dhe të konsiderueshme që prej vitit 2014, që arriti pikën më kulmore prej 4.1% në vitin 2018. Ky ngadalësim ka ardhur kryesisht si pasojë e faktorëve të paqëndrueshëm apo të përkohshëm përgjatë vitit 2019. Rritja reale e PBB-së u rrit me 2.95%, përgjatë nëntë muajve të vitit 2019, bazuar në vlerësimet tremujore të INSTAT-it, ndërkohë që vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2019, ritmi i rritjes rezultoi më i lartë se sa dy tremujorët e mëparshëm, në rreth 3.81%.



Sipas optikës së kërkesës agregate, rritja, përgjatë nëntë muajve të vitit 2019, u gjenerua nga konsumi final, si dhe nga kërkesa e brendshme. Ndërsa për tremujorin e tretë, kërkesa e brendshme vlerësohet se është nxitur kryesisht nga kontributi i konsumit. Duke marrë në konsideratë performancën e nëntë muajve të vitit 2019 dhe pritshmëritë për tremujorin e katërt 2019, i cili pritet të pasqyrojë edhe efektet e tërmetit që goditi Shqipërinë në muajin nëntor të këtij viti, rritja ekonomike për të gjithë vitin 2019 pritet të jetë rreth 2.7%.

Konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, u rrit me rreth 3.0% në terma realë vjetorë, përgjatë nëntë muajve të parë të 2019-ës, ndërsa konsumi final i popullatës u rrit me rreth 3.12%. Ndërkohë, vetëm për tremujorin e tretë, konsumi final total dhe ai i popullatës shënuan përshpejtim të ritmit krahasuar me dy tremujorët paraardhës, resperktivisht në 3.63% dhe 3.89%.

Formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale) pati rënie me rreth 0.37% në terma realë vjetorë, përgjatë nëntë muajve të vitit 2019, ndërkohë vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2019 kjo normë ishte -1.91%. Kjo rënie i atribuohet kryesisht aktivitetit në përfundim të projektit të TAP-së.

Referuar statistikave të llogarive kombëtare tremujore të INSTAT-it, përgjatë nëntë muajve të vitit 2019, eksportet e mallrave dhe të shërbimeve kanë kontribuar pozitivisht. Tkurrja e eksporteve të mallrave është kundërpeshuar nga rritja e eksporteve të shërbimeve, ku këto të fundit reflektojnë kryesisht një performancë të mirë të turizmit edhe përgjatë kësaj periudhe. Gjithsesi, kontributi pozitiv i eksporteve totale (mallra dhe shërbime) është kundërpeshuar nga efekti negativ i importeve, si rrjedhojë e rritjes dhe e peshës specifike të lartë të këtyre të fundit, duke bërë që kërkesa e huaj neto në total të ketë një efekt vetëm lehtësisht pozitiv në rritjen reale ekonomike të nëntë muajve të 2019.

Nga optika e ofertës agregate, sektorët që dhanë një kontribut të qenësishëm pozitiv në rritjen ekonomike përgjatë nëntë muajve të vitit 2019 ishin: i. aktivitete financiare dhe të sigurimit, me një rritje reale vjetore prej rreth 11.6% dhe një kontribut prej 0.34 pikë përqindjeje; ii. aktivitete të pasurive të paluajtshme, me një rritje vjetore prej rreth 7.61% dhe një kontribut prej 0.45 pikë përqindjeje; iii. informacioni dhe komunikimi, me një rritje vjetore prej rreth 6.38% dhe një kontribut prej 0.18 pikë përqindjeje; iv. aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike me një rritje reale vjetore prej rreth 6.31% dhe një kontribut prej 0.37 pikë përqindjeje; v. tregtia me shumicë dhe me pakicë etj., me një rritje vjetore prej rreth 5.77% dhe një kontribut prej 0.9 pikë përqindjeje.

Nga ana tjetër, dinamika e tregut të punës ka vijuar performancën pozitive. Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT-i, punësimi deri në tremujorin e tretë të vitit 2019 u rrit me 2.6% krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë ose me rreth 31 mijë të punësuar. Norma e papunësisë (për grup-moshën 15–64 vjeç) ka vijuar trendin e saj rënës që prej T1-2014, ku regjistroi vlerën e saj më të lartë prej 18%, duke zbritur tashmë në nivelin 11.8% në T3-2019, me një reduktim prej 0.8 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë (T3-2018) ose me një reduktim të numrit të personave të papunë prej rreth 8.2 mijë në harkun kohor të një viti. Ndërkohë, për grup-moshën 15 vjeç e sipër, norma e papunësisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2019 regjistroi nivelin prej 11.4%.

Bazuar në statistikat e bilancit të pagesave të BSH-së, bilanci i pagesave (BP) për periudhën janar–shtator të vitit 2019, shënoi rënie kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë, duke arritur vlerën -4.6 milionë euro, nga 97.9 milionë euro më 2018-ën. Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë të 2019-ës, BP-ja regjistroi balancë pozitive prej 110 milionë eurosh, krahasuar me tremujorin e tretë të 2018-ës, ku, gjithashtu, shënonte balancë pozitive prej +155 milionë euro.

Deficiti tregtar u thellua lehtësisht gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2019, me rreth 12%, si rezultat i një tkurrjeje të eksporteve, ku dinamika e energjisë elektrike krahasuar me një vit më parë ishte faktor dominant, si dhe rritje të volumit të importeve. Gjithashtu, deficiti i llogarisë korrente u përkeqësua me rreth 40%, përgjatë periudhës nëntëmujore. Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë, deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 161 milionë euro. Thellimi i deficitit korrent, në masën më të madhe është diktuar nga zgjerimi i deficitit tregtar në mallra - në reflektim të rritjes së shpenzimeve për importe dhe të rënies së të ardhurave nga eksportet. Në të njëjtën kohë, zgjerimi i balancës negative të të ardhurave (parësore) nga investimet ka qenë faktor shtesë në thellimin e deficitit korrent.

Në gamën e eksporteve të shërbimeve, ato që ndikuan më së shumti ishin shërbimet e ndërlidhura kryesisht me aktivitetin e sektorit turistik, të cilat u rritën me rreth 11.5%, duke

kontribuar konsiderueshëm në reduktimin e deficitit të llogarisë korrente. Po ashtu, remitancat u rritën me rreth 3.9%, megjithatë kontributi i tyre në përmirësimin e llogarisë korrente ishte disi më margjinal, duke qenë se pesha e tyre është zvogëluar ndjeshëm përgjatë vjetëve të fundit.

Llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në vlerën +785 milionë euro, gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2019 krahasuar me +660 milionë euro, që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë, ku flukset hyrëse nga investimet e huaja direkte u rritën me rreth 7.3% kundrejt një viti më parë. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2019, llogaria financiare dhe kapitale u zvogëlua në +155 milionë euro, krahasuar me +195 milionë euro në tremujorin e tretë të 2018-ës.

Inflacioni, përgjatë vitit 2019, ka shënuar ritme më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Inflacioni mesatar për periudhën për vitin 2019 është në nivelin 1.4%, referuar të dhënave më të fundit nga INSTAT-i.

2. Politikat fiskale

Politika fiskale, për periudhën afatmesme 2021–2023, do të jetë e orientuar drejt konsolidimit fiskal, ndërkohë që siguron një nivel optimal investimesh prej mbi 4.5 përqindësh të PBB-së. Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik është thelbësor për uljen e risqeve makroekonomike, të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Objektivat e politikës fiskale në KMF, 2021–2023, janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskalë të ligjit organik të buxhetit (shih kuadratin në faqen 7).



Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 2.0 përqindësh të PBB-së për 2021-shin, nga 2.2 për qind i programuar për vitin 2020-ën; nivel prej 1.7 për qindësh të PBB-së në 2022-shin; dhe 1.3 përqindësh në vitin 2023. Njëkohësisht targeton në vijimësi një balancë primare pozitive dhe në rritje, për vitet 2021–2023, respektivisht 0.5 për qind në 2021-shin nga 0.1 për qind i targetuar në buxhetin 2020; 0.8 për qind në 2022-shin; dhe 1.2 për qind në vitin 2023. Po ashtu, edhe balanca korrente, pra diferenca midis investimeve publike dhe deficitit (huamarrjes) vjetore, targetohet në nivele të larta përgjatë horizontit afatmesëm. Respektivisht, balanca korrente në vitin 2021 targetohet në nivelin 2.8 për qind të PBB-së, më tej targetohet në nivelin 3.1 për qind në vitin 2022 dhe 3.3 për qind në vitin 2023.

Ky konsolidim fiskal synon që niveli i borxhit publik, si raport ndaj PBB-së, të vijojë trajektoren e sigurt rënëse të nisur që në vitin 2016. Borxhi publik neto (i zhveshur nga gjendja e mjeteve likuide të qeverisë) pritet që të bjerë rreth nivelit 62.2 për qind të PBB-së në 2021-shin, 60.5% në vitin 2022 dhe, më tej, pritet të vijojë reduktimin në 58.6 për qind në vitin 2023.

Edhe për periudhën afatgjatë politika fiskale do të vijojë të mbetet qartësisht e orientuar drejt konsolidimit fiskal, duke synuar një ulje të borxhit publik, me të paktën ,mesatarisht 1.5 pikë përqindjeje të PBB-së në çdo vit, deri sa niveli i tij të arrijë objektivin afatgjatë prej 45% të PBB-së të përcaktuar në rregullat fiskalë të ligjit organik të buxhetit.

Në të njëjtën kohë, ky kuadër fiskal akomodon politika buxhetore për të mbështetur rritjen ekonomike dhe për të kompensuar efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Investimet publike

në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme parashikohen të mbahen mbi 4.5 për qind të PBB-së, nivel i cili vlerësohet si optimal për të ushqyer kërkesën agregate në afat të shkurtër dhe për ta zhvendosur rritjen potenciale ekonomike në një nivel të më të lartë në afat të mesëm dhe të gjatë.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 57/2016, KMF 2021–2023, materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të produktit të brendshëm bruto.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, KMF 2021–2023 *targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB-së më të ulët se sa niveli i vitit pararendës.*

2. Vlera e produktit të brendshëm bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto, për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin "Perspektiva ekonomike botërore" (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-së, Kuadri 2021–2023, *bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB-së nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve të raportit "Perspektiva ekonomike botërore" (World Economic Outlook)*[1], të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar më tetor 2019.

Parashikimet e PBB nominale të FMN dhe MFE (në miliardë Lekë)

	2017	2018	2019 Fore.	2020 Fore.	2021 Fore.	2022 Fore.	2023 Fore.
IMF - World Economic Outlook	1,551.3	1,626.2	1,705.4	1,809.0	1,926.0	2,062.7	2,209.1
MFE	1,551.3	1,630.9	1,688.9	1,777.2	1,879.8	1,990.2	2,106.4
Difference FMN - MFE (diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e vogël se zero)	0.0	-4.7	16.5	31.8	46.1	72.5	102.6

3. Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-Së, Kuadri 2021–2023, përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar "Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit etj." **një kontigjencë prej mbi 0.7 përqindësh e shpenzimeve totale**.

4. Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 4/1 të ligjit organik të buxhetit nr. 57/2016, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB-Së, Kuadri 2021–2023, **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme**.

5. Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

---

[1] Linku për aksesimin e raportit WEO: https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2019/10/01/world-economic-outlook-october-2019.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – "rregulli i artë") të LOB-Së, deficiti i targetuar në Kuadrin 2021–2023 **është çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.** Rrjedhimisht, balanca korrente e targetuar është pozitive prej mesatarisht 3 për qind të PBB-Së në çdo vit të programuar.

3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukturore qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë brenda kontureve të ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve, si: INSTAT, BSH, MFE, FMN, BB, Eurostat etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përftuar synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelorë të miksit të politikave fiskale e monetare, përgjatë tre vjetëve në vijim, nëpërmjet të cilëve synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies së Bashkimit Evropian, janë:

- targetimi i një trajektoreje rënëse të borxhit publik, duke synuar nivelin e borxhit publik neto rreth nivelit 60 për qind të PBB-së në vitin 2022 dhe, më tej, rreth nivelit 58.6 për qind të PBB-së në vitin 2023.
- mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe, mundësisht mbi nivelin 4.5 për qind të PBB-së.
- harmonizimi me objektivin themelor të politikës monetare për stabilitetin e çmimeve e cila targeton një normë inflacioni në nivelin 3 për qind dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli.
- zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë, duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 4 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këta objektiva fondamentalë përbëjnë konturet bazë të këtij programi ekonomik e fiskal, brenda të cilëve përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Ekonomia pritet të vazhdojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të qëndrojë në nivelin prej 4% gjatë tre vjetëve tjerë, 2021–2023.

Gjatë periudhës afatmesme, rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto (eksport-import) pritet të sjellë, gjithashtu, një efekt pozitiv, por margjinal. Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit pritet të transmetohen në një rritje graduale të pagave, të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredimarrjeje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja për konsum

parashikohet të nxitet nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar.

Ndërsa, rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga shfrytëzimi më i intensifikuari kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, i vërejtur së fundmi, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik, gjatë periudhës së parashikuar, dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht, edhe vijimësia e përmirësimit të kushteve financiare dhe i lehtësimit të standardeve të huadhënies pritet të jetë një faktor i rëndësishëm incentivues i investimeve private në afatin e mesëm.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2021–2023) parashikohet të rritet në terma realë, me mesatarisht rreth 3% në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.7 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa, investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma realë mbi nivelin 5%, në vitet 2022 dhe 2023, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 0.9 pikë përqindjeje në vit.

Kërkesa e jashtme neto pritet të ketë efekte pozitive minimale në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara, duke supozuar se nuk do të ketë goditje të ndjeshme negative të çmimeve të naftës dhe mineraleve në tregjet ndërkombëtare. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten, gjithashtu, të vijojnë performancën pozitive në periudhën afatmesme dhe do të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe të shërbimeve, për periudhën 2021–2023, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 7.2% në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 2.3 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe të shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 4.3% në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së, me rreth -1.9 pikë përqindjeje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto, kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen totale të PBB-së, me mesatarisht rreth 0.4 pikë përqindjeje në vit.

Grafik. Rritja reale (majtas në %) dhe kontributet në rritje (djathtas në p.p.), sipas komponentëve të kërkesës agregate



Burimi: INSTAT, MFE

Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, politika buxhetore e qeverisë për të ruajtur një nivel të investimeve publike në mbi 4.5% të PBB-së në vitet 2021–2023 do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Në të njëjtën kohë, vijimi i politikës monetare akomoduese parashikuar

në periudhën afatmesme, duke marrë parasysh presionet e ulëta inflacioniste, do të mbështesë konsumin privat dhe investimet.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut në periudhën afatmesme dhe do të rrisë hapësirat për stimulim në sektorin privat, fondamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritjeje të lartë e të qëndrueshme. Në të njëjtën kohë, komponentët e politikave buxhetore të planifikuara do të mbështesin rritjen, duke kundërpeshuar efektin shtrëngues të konsolidimit fiskal.

Grafik. Rritja reale (majtas në %) dhe kontributet në rritje (djathtas në p.p.), sipas komponentëve të ofertës agregate



Burimi: INSTAT, MFE

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht, bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 1.3% në vit në terma realë, përgjatë periudhës 2021–2023; , me një mesatare vjetore prej rreth 5.2%; ndërtimi, me rreth 3.4% dhe shërbimet, me një mesatare prej rreth 4.7% në vit. Megjithatë, për shkak të peshës së tyre ndaj strukturës së ofertës agregate, shërbimet pritet të kontribuojnë më shumë se sa sektorët e tjerë në rritjen e PBB-së.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 1.2% në vit, gjatë viteve 2021–2023. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë pak a shumë të njëjtën strukturë të perspektivës së ofertës agregate të aktivitetit ekonomik. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Pavarësisht zgjerimit të pritshëm të punësimit në afatin e mesëm, sërish produktiviteti i përgjithshëm i punës pritet të ketë një përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe.

Grafik. Punësimi (në të majtë rritja vjetore në %) dhe norma e papunësisë (në të djathtë në %)



Burimi: INSTAT, MFE

Presionet inflacioniste parashikohet të forcohen në periudhën afatmesme. Inflacioni pritet të rritet gradualisht dhe të rikthehet në objektivin e politikës monetare, brenda vitit 2023. Presionet e brendshme inflacioniste priten të përshpejtohen si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe investimeve, të cilat do të mbështesin një ritëm më të shpejtë të rritjes ekonomike. Për më tepër, parashikimi për forcimin e kërkesës agregate dhe të inflacionit në mjedisin ndërkombëtar pritet të përçojnë një efekt inflacionist disi më të rritur në ekonominë shqiptare për periudhën afatmesme në vijim.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në lidhjen nr. 1 bashkëngjitur VKM-së.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave fiskale të ndërmarra, efekteve të pritshme të përmirësimit administrativ, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vjetët në vijim (2021–2023) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 4.5 për qind në çdo vit. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.2 përqindësh.

Grafik. Të ardhurat (majtas në miliard lek, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Duke qëndruar brenda konturеve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tre vjetët në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave të sipërpërmendur të deficitit fiskal për këtë periudhë, burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar, gjatë viteve 2021–2023, pritet të jenë mesatarisht në rreth 583 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 29.3 për qind e PBB-së. Investimet publike të qeverisë qendrore janë programuar të mbahen në

një nivel mesatarisht prej rreth 4.7 përqindësh të PBB-së në çdo vit (ose rreth 5.5 për qind të PBB-së nëse konsiderohen edhe investimet e qeverisë lokale). Këto konsiderohen nivele optimale për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Grafik. Shpenzimet (majtas në miliard lekë, djathtas në për qind të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2 bashkëngjitur VKM-së, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB-në.

TREGUESIT KRYESORË MAKROEKONOMIKË

Treguesit	Njësia	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
					Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.88	2.87	2.87	2.86	2.86	2.85	2.84	2.84
Inflacioni (mesatar)	%	1.3	2.0	2.0	1.4	2.1	2.4	2.8	3.0
Deflatori i PBB	%	-0.6	1.5	0.9	0.8	1.1	1.7	1.8	1.8
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	124.1	119.1	108.0	109.9	109.9	109.9	109.9	109.9
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	137.4	134.2	127.6	123.0	123.0	123.0	123.0	123.0
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit te Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	43.1	41.8	42.6	42.6	42.6	42.6	42.6	42.6
Rritja reale e PBB	%	3.3	3.8	4.1	2.7	4.1	4.0	4.0	4.0
PBB	Lek miliardë	1,472.5	1,551.3	1,630.9	1,688.9	1,777.2	1,879.8	1,990.2	2,106.4
PBB	USD miliardë	11.9	13.0	15.1	15.4	16.2	17.1	18.1	19.2
PBB	Euro miliard	10.7	11.6	12.8	13.7	14.4	15.3	16.2	17.1
PBB për banor	Lek mijë	512.0	539.9	569.0	590.0	622.1	659.5	699.9	742.9
PBB për banor	USD	4,124.0	4,532.9	5,268.9	5,371.1	5,663.2	6,003.5	6,371.6	6,762.4
PBB për banor	Euro	3,727.1	4,024.3	4,459.5	4,796.4	5,057.1	5,361.0	5,689.8	6,038.8
PBB për banor	USD-PPP	11,868.2	12,930.1	13,364.1	13,858.4	14,611.9	15,489.9	16,439.7	17,448.1
PBB për banor	Euro-PPP	9,206.8	9,706.9	10,210.4	10,588.0	11,163.7	11,834.5	12,560.2	13,330.6
Norma e papunësisë (15-64 vjec)	%	15.6	14.1	12.8	12.2	10.8	9.9	9.4	9.0
Të ardhurat totale	% të PBB	27.6	27.7	27.6	27.4	28.7	27.7	27.6	27.6
Shpenzimet totale	% të PBB	29.5	29.7	29.2	29.3	30.9	29.6	29.3	29.0
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-2.2	-2.0	-1.7	-1.3
Bilanci primar fiskal	% të PBB	0.7	0.1	0.6	0.2	0.1	0.5	0.8	1.2
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	2.6	3.0	3.2	2.5	3.5	2.8	3.1	3.3
Huamarrja e brendshme neto	% të PBB	0.7	1.0	1.2	1.1	1.7	1.2	1.2	1.1
Të ardhura nga privatizimet	% të PBB	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Huamarrje totale neto	% të PBB	1.9	2.9	3.2	0.7	2.5	0.4	3.0	0.2
Borxhi publik NETO nga qjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	71.7	68.7	64.9	64.5	63.6	62.2	60.5	58.6
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	72.4	70.1	67.9	66.2	65.4	62.3	62.0	58.8
Borxhi publik i qeverise se pergjithshme	% të PBB	68.7	66.9	65.1	63.5	62.9	59.8	59.5	56.4
Borxhi publik jashte treguesve fiskale	% të PBB	3.7	3.3	2.8	2.6	2.6	2.5	2.5	2.4
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-7.6	-7.5	-6.8	-8.0	-7.2	-6.7	-6.3	-6.0
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-16.8	-15.1	-13.8	-14.4	-13.5	-12.7	-11.9	-11.4
Mallra	% të PBB	-24.3	-24.4	-22.5	-23.5	-23.2	-23.0	-22.5	-22.2
Eksporte	% të PBB	6.7	6.9	7.7	6.6	6.9	7.1	7.3	7.4
Importe	% të PBB	-30.9	-31.3	-30.2	-30.1	-30.1	-30.0	-29.8	-29.7
Bilanci i pagesave	% të PBB	0.4	1.6	2.9	0.3	1.4	1.4	1.8	2.1
Rezervat valutore	Euro milion	2,945.0	2,995.9	3,367.3	3,411.7	3,619.8	3,836.8	4,123.9	4,475.1
Në muaj importi mall. e shërb.	Muaj	7.2	6.7	6.9	6.6	6.6	6.7	6.8	7.0

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

(në milion lek)

Nr.	E M Ë R T I M I	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
					I Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	407,021	430,397	449,909	462,466	509,675	520,378	549,522	581,768
I.	Ndihmat	14,639	11,085	8,164	8,940	23,000	16,000	16,000	16,000
II.	Të ardhura tatimore	369,884	398,629	419,333	430,469	465,090	480,528	509,272	541,318
II.1	*Nga tatimet dhe doganat*	275,780	293,386	304,318	309,141	334,121	343,259	364,407	388,214
II.2	*Të ardhura nga pushteti lokal*	14,951	18,447	21,863	22,971	26,944	27,426	28,632	30,354
II.3	*Të ardhura nga fondet speciale*	79,153	86,795	93,153	98,357	104,025	109,843	116,233	122,751
III.	Të ardhura jo-tatimore	22,498	20,683	22,412	23,057	21,585	23,850	24,250	24,450
	TOTALI I SHPENZIMEVE	433,697	461,410	476,147	495,366	549,374	557,251	582,417	609,878
I.	Shpenzime Korrente	368,720	382,287	397,345	419,983	446,034	466,827	486,016	509,381
I.1	*Personeli*	67,540	72,642	73,582	77,214	83,203	86,473	90,273	93,273
	Paga	58,215	62,581	62,174	65,852	70,414	70,609	71,509	73,909
	Kontributi për sigurime shoqërore	9,325	10,061	10,304	10,577	11,488	11,664	12,464	13,064
	Fondi i veçantë i pagave					300	400	400	400
	Politika të reja pagash						3,000	5,000	5,000
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta			1,103	785	1,000	800	900	900
I.2	*Interesat*	36,259	31,904	36,513	35,800	40,950	46,111	48,840	53,094
	Të brendshme	25,528	21,415	23,158	23,100	23,500	27,771	29,444	31,163
	Të huaja	10,733	10,489	13,355	12,700	13,450	13,840	13,396	14,431
	Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj					4,000	4,500	6,000	7,500
I.3	*Shpenzime operative e mirëmbajtje*	44,329	43,441	45,498	47,452	49,846	52,198	53,548	56,448
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)				44,502	46,546	48,848	50,048	52,948
	Arsimi i lartë				500	1,000	800	900	900
	Të tjera jashtë limitit				2,450	2,300	2,550	2,600	2,600
I.4	*Subvencionet*	1,725	2,310	1,883	1,490	1,290	1,490	1,490	1,490
I.5	*Shpenzime për fondet speciale*	152,591	162,146	168,249	177,427	188,592	196,391	204,891	214,491
	Sigurime shoqërore	114,276	119,081	125,364	132,418	137,488	143,465	150,465	159,065
	Politika të reja pensionesh					2,520	2,620	3,120	3,120
	Sigurime shëndetësore	34,796	39,090	40,154	41,900	44,104	45,306	45,806	46,806
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	3,519	3,974	2,731	3,109	4,500	5,000	5,500	5,500
I.6	*Buxheti lokal*	43,580	46,487	49,615	55,736	57,554	58,764	61,123	64,135
	Granti nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	28,629	28,039	27,753	26,645	26,040	26,638	27,742	29,031
	Fondi i pakushtezuar				19,212	18,200	18,798	19,902	21,064
	Grant Specifik				7,433	7,840	7,840	7,840	7,967
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	14,951	18,447	21,863	25,123	26,944	27,426	28,632	30,354
	Taksa të ndara				430	670	700	750	750
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				2,300	2,900	3,000	3,000	3,000
	Financim i huaj vendor dhe te tjera te mbartura				1,239	1,000	1,000	1,000	1,000
I.7	*Transferta të tjera*	22,696	23,357	22,004	24,864	24,600	25,400	25,850	26,450
	Pagesa e papunësisë	691	346	336	540	600	600	600	600
	Ndihma ekonomike	20,026	20,714	20,671	20,800	21,000	21,300	21,650	22,150
	Kompensim për të përndjekurit politikë	1,979	2,298	997	1,200	1,000	1,000	1,000	1,000
	Bonusi i lindjeve				2,324	2,000	2,500	2,600	2,700
II.	Fondi rezervë					1,700	1,800	2,000	2,500
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave					1,700	1,800	2,000	2,500
III.	Shpenzime kapitale	59,478	68,455	78,434	75,383	101,639	88,624	94,401	97,997
	Financim i brendshëm	39,118	46,177	51,552	49,570	51,321	51,564	57,241	58,337
	Nga e cila: Fondi per infrastrukturen vendore dhe rajonale					4,000	3,000	3,000	3,000
	Transferte kapitale per AC					200			
	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta			672	883	1,000	1,000	1,000	1,000
	Financim i huaj	20,360	22,278	26,210	24,950	29,318	31,060	34,160	38,660
	Nga te cilat: energjia				1,900	1,500	2,300	2,100	2,000
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit					20,000	5,000	2,000	
IV.	Detyrimet e prapambetura								
V.	Të tjera	5,499	9,217	368					
VI.	Fond shpronësimi		1,450						
	DEFIÇITI	-26,676	-31,012	-26,238	-32,900	-39,699	-36,873	-32,895	-28,110
	FINANCIMI DEFIÇITIT	26,676	31,012	26,238	32,900	39,699	36,873	32,895	28,110
I.	*I brendshëm*	9,176	1,899	-6,866	40,366	25,525	53,013	-4,766	47,850
	Të ardhura nga privatizimi	2,805	418	104	0	0	0	0	0
	Hua-marrje e brendshme (neto)	10,602	16,285	19,591	18,482	29,900	22,900	22,900	22,900
	Të tjera, nga të cilat:	-4,231	-14,804	-26,561	21,884	-4,375	30,113	-27,666	24,950
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	298	-10,962	-30,533	21,884	-4,375	30,113	-27,666	24,950
II.	*I huaj*	17,500	29,113	33,104	-7,466	14,174	-16,140	37,661	-19,740
	Hua afatgjatë (e marrë)	18,780	23,407	83,761	20,570	76,903	17,560	81,745	25,160
	Per projekte			21,232	20,570	15,818	17,560	20,660	25,160
	Eurobond			62,529	0	61,085	0	61,085	0
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-408	169	106	0	0	0	0	0
	Ripagesat	-21,998	-25,769	-51,678	-29,679	-66,230	-40,700	-44,084	-44,900
	Eurobond			-25,012	0	-30,543	0	0	0
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	21,126	31,306	916	1,643	3,500	7,000	0	0
	MEMO:								
	Balanca e përgjithshme (deficiti përgjithshëm)	-26,676	-31,012	-26,238	-32,900	-39,699	-36,873	-32,895	-28,110
	Balanca korente	38,301	46,660	52,197	42,483	61,940	51,751	61,506	69,887
	Balanca primare	9,583	891	10,276	2,900	1,251	9,238	15,945	24,985
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	10,464	21,904	49,440	27,556	31,931	1,818	29,484	4,534
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	1,056,146	1,066,265	1,057,845	1,089,792	1,130,816	1,169,238	1,203,683	1,233,343
	Borxhi publik BRUTO (stok)	1,066,610	1,088,169	1,107,285	1,117,348	1,162,746	1,171,056	1,233,168	1,237,878
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	1,012,241	1,037,457	1,061,897	1,072,913	1,116,986	1,123,746	1,184,307	1,187,467
	I brendshëm (stok)	530,834	546,939	565,093	583,575	613,475	636,375	659,275	682,175
	I huaj (stok)	481,407	490,518	496,804	489,338	503,512	487,372	525,033	505,293
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	54,369	50,712	45,388	44,435	45,760	47,310	48,860	50,410
	Pushteti vendor (stok)	901	827	716	700	750	800	850	900
	Borxhi publik i garantuar (stok)	53,468	49,885	44,672	43,735	45,010	46,510	48,010	49,510
	PBB nominal	1,472,480	1,551,281	1,630,905	1,688,894	1,777,176	1,879,843	1,990,207	2,106,422

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

LIDHJA NR. 2/2

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

(në përqindje të PBB-së)

Nr.	EMËRTIMI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
					I Pritshmi	Buxhet	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	27.6	27.7	27.6	27.4	28.7	27.7	27.6	27.6
I.	Ndihmat	1.0	0.7	0.5	0.5	1.3	0.9	0.8	0.8
II.	Të ardhura tatimore	25.1	25.7	25.7	25.5	26.2	25.6	25.6	25.7
II.1	*Nga tatimet dhe doganat*	18.7	18.9	18.7	18.3	18.8	18.3	18.3	18.4
II.2	*Të ardhura nga pushteti lokal*	1.0	1.2	1.3	1.4	1.5	1.5	1.4	1.4
II.3	*Të ardhura nga fondet speciale*	5.4	5.6	5.7	5.8	5.9	5.8	5.8	5.8
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.5	1.3	1.4	1.4	1.2	1.3	1.2	1.2
	TOTALI I SHPENZIMEVE	29.5	29.7	29.2	29.3	30.9	29.6	29.3	29.0
I.	Shpenzime Korrente	25.0	24.6	24.4	24.9	25.1	24.8	24.4	24.2
I.1	*Personeli*	4.6	4.7	4.5	4.6	4.7	4.6	4.5	4.4
	Paga	4.0	4.0	3.8	3.9	4.0	3.8	3.6	3.5
	Kontributi për sigurime shoqërore	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6	0.6
	Fondi i veçantë i pagave						0.0	0.0	0.0
	Politika të reja pagash						0.2	0.3	0.2
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta			0.1	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
I.2	*Interesat*	2.5	2.1	2.2	2.1	2.3	2.5	2.5	2.5
	Të brendshme	1.7	1.4	1.4	1.4	1.3	1.5	1.5	1.5
	Të huaja	0.7	0.7	0.8	0.8	0.8	0.7	0.7	0.7
	Kontigjenë për luhatjet e normave të interesit, etj					0.2	0.2	0.3	0.4
I.3	*Shpenzime operative e mirëmbajtje*	3.0	2.8	2.8	2.8	2.8	2.8	2.7	2.7
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)				2.6	2.6	2.6	2.5	2.5
	Arsimi i lartë				0.0	0.1	0.0	0.0	0.0
	Të tjera jashtë limitit				0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.4	*Subvencionet*	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	*Shpenzime për fondet speciale*	10.4	10.5	10.3	10.5	10.6	10.4	10.3	10.2
	Sigurime shoqërore	7.8	7.7	7.7	7.8	7.7	7.6	7.6	7.6
	Politika të reja pensionesh					0.1	0.1	0.2	0.1
	Sigurime shëndetësore	2.4	2.5	2.5	2.5	2.5	2.4	2.3	2.2
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.2	0.3	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3	0.3
I.6	*Buxheti lokal*	3.0	3.0	3.0	3.3	3.2	3.1	3.1	3.0
	Granti nga Buxheti i Shtetit per pushtetin vendor	1.9	1.8	1.7	1.6	1.5	1.4	1.4	1.4
	Fondi i pakushtezuar				1.1	1.0	1.0	1.0	1.0
	Grant Specifik				0.4	0.4	0.4	0.4	0.4
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	1.0	1.2	1.3	1.5	1.5	1.5	1.4	1.4
	Taksa të ndara				0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				0.1	0.2	0.2	0.2	0.1
	Financimi i huaj vendor dhe te tjera te mbartura				0.1	0.1	0.1	0.1	0.0
I.7	*Transferta të tjera*	1.5	1.5	1.3	1.5	1.4	1.4	1.3	1.3
	Pagesa e papunësisë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ndihma ekonomike	1.4	1.3	1.3	1.2	1.2	1.1	1.1	1.1
	Kompensim për të përmdjekurit politikë	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0
	Bonusi i lindjeve				0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë					0.1	0.1	0.1	0.1
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave					0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Shpenzime kapitale	4.0	4.4	4.8	4.5	5.7	4.7	4.7	4.7
	Financimi i brendshëm	2.7	3.0	3.2	2.9	2.9	2.7	2.9	2.8
	Nga e cila: Fondi per infrastrukturen vendore dhe rajonale					0.2	0.2	0.2	0.1
	Transferte kapitale per AC					0.0	0.0	0.0	0.0
	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta			0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0
	Financimi i huaj	1.4	1.4	1.6	1.5	1.8	1.7	1.7	1.8
	Nga te ulet: energjia				0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Fondi i rindërtimit pas tërmetit					1.1	0.3	0.1	
IV.	Detyrimet e prapambetura								
V.	Të tjera	0.4	0.6	0.0					
VI.	Fond shpronësimi		0.1						
	DEFIÇITI	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-2.2	-2.0	-1.7	-1.3
	FINANCIMI DEFIÇITIT	1.8	2.0	1.6	1.9	2.2	2.0	1.7	1.3
I.	*I brendshëm*	0.6	0.1	-0.4	2.4	1.4	2.8	-0.2	2.3
	Të ardhura nga privatizimi	0.2	0.0	0.0					
	Hua-marrje e brendshme (neto)	0.7	1.0	1.2	1.1	1.7	1.2	1.2	1.1
	Të tjera, nga të ulet	-0.3	-1.0	-1.6	1.3	-0.2	1.6	-1.4	1.2
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	0.0	-0.7	-1.9	1.3	-0.2	1.6	-1.4	1.2
II.	*I huaj*	1.2	1.9	2.0	-0.4	0.8	-0.9	1.9	-0.9
	Hua afatgjatë (e marrë)	1.3	1.5	5.1	1.2	4.3	0.9	4.1	1.2
	Per projekte			1.3	1.2	0.9	0.9	1.0	1.2
	Eurobond			3.8	0.0	3.4	0.0	3.1	0.0
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Ripagesat	-1.5	-1.7	-3.2	-1.8	-3.7	-2.2	-2.2	-2.1
	Eurobond			-1.5	0.0	-1.7	0.0	0.0	0.0
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	1.4	2.0	0.1	0.1	0.2	0.4	0.0	0.0
	MEMO:								
	Balanca e përgjithshme (deficiti përgjithshëm)	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-2.2	-2.0	-1.7	-1.3
	Balanca korente	2.6	3.0	3.2	2.5	3.5	2.8	3.1	3.3
	Balanca primare	0.7	0.1	0.6	0.2	0.1	0.5	0.8	1.2
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	0.7	1.4	3.0	1.6	1.8	0.1	1.5	0.2
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	71.7	68.7	64.9	64.5	63.6	62.2	60.5	58.6
	Borxhi publik BRUTO (stok)	72.4	70.1	67.9	66.2	65.4	62.3	62.0	58.8
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	68.7	66.9	65.1	63.5	62.9	59.8	59.5	56.4
	I brendshëm (stok)	36.1	35.3	34.6	34.6	34.5	33.9	33.1	32.4
	I huaj (stok)	32.7	31.6	30.5	29.0	28.3	25.9	26.4	24.0
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	3.7	3.3	2.8	2.6	2.6	2.5	2.5	2.4
	Pushteti vendor (stok)	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Borxhi publik i garantuar (stok)	3.6	3.2	2.7	2.6	2.5	2.5	2.4	2.4
	PBB nominal	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë